



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MEMALIAJ
DREJTORIA E TATIM TAKSAVE

Nr 2330 Prot

Memaliaj, më 16/12 2025

RELACION

PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE PËR VITIN 2026
(PAKETA FISKALE) BASHKIA MEMALIAJ

Në mbështetje të nenit 54, shkronja "f", të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" to ndryshuar Ligjit Nr. 9920 datë 19.5.2008 "Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar, Ligjin nr.10304, datë 15.7.2010."Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, ligjin.Nr.57/2020, "Për pyjet ", Ligjin Nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", i ndryshuar, Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" ndryshuar, VKM nr.559 datë 29.07.2022"Për përcaktimin e cmimeve dhe për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit të pyjeve kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore e jo drusore pyjore dhe të kullotave", i ndryshuar, Ligjin Nr.10.465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë"; Ligjin nr.152/2015, datë 21.12.2015,"Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", VKM Nr.607 datë 29.07.2020 " Për tarifat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", VKM nr.784 datë 09.11.2016" Për mënyrën dhe kriteret e llogaritjes së shpenzimeve të ndërhyrjes për shuarjen e zjarreve në objektet e siguruara administrimin e përdorimit të ardhurave, për llogari të shërbimit vendor të MZSH-së", VKM Nr.632, datë 11.6.2009 "Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje" VKM nr.467 date 31.07.2025 " Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje ose kositje , për veprimtari shoqërore , shëndetësore , sportive e turistike dhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme " , VKM nr.783 datë 10.11.2011 " Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njesitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 107/2014 datë 31.07.2014" Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", " , VKM nr.132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin

alternativ të detyrimit të taksës": "Ligji nr 24/2017" për administrimin e Ujitjes dhe Kullimit", Neni 15 I ligjit nr 8378, datë 22.07.1998 "kodi rrugor" (I ndryshuar). Neni 32 Pikat 7 dhe 8 të rregullores nr 22 AKEP datë 24.06.2011 "mbi kushtet teknike për ndertimet e infrastruktureve të rrjeteve kablllore Urbane dhe rrjeteve me fibra optike ndër Urbane të komunikimeve elektronike" I ndryshuar,; Neni 10, pika 3 e nenit 12, I ligjit 10.279 datë 20.05.2010 "për kundravajtjet administrative"

Po ju paraqesim për shqyrtim e miratim si mëposhtë:

1- TARIFË PARKIMI

Kjo tarife aplikohet për here të pare në paketën fiskale në Bashkinë Memaliaj meqenese rruga "Tafil Buzi" do të bëhet me një sens kalimi dhe nga të dyja anët me parkim kemi menduar të vendosim një tarife parkimi (bashkangjitur tabela). Nga kjo tarife përjashtohen rezidentë banimi dhe invalidët. Segmenti rrugor përkon nga Posta Shqiptare – Vodafon.

	2-TARIFË PARKIMI	Lekë /Ora
	-Për çdo automjet për udhëtarë apo automjet transport malli në vendet e parkimit me pagesë për qytetin Memaliaj, rruga "Tafil Buzi".	50 Lekë/ ora
	- Për çdo automjet për udhëtarë apo automjet transport malli në vendet e parkimit me pagesë për qytetin Memaliaj, rruga "Tafil Buzi".	Jo më shumë se 100 lek/ dita

2- TARIFA PËR KAMPERAT BRENDË TERRITORIT TË BASHKISË MEMALIAJ

Meqenese turizmi ka paur një rritje të ndjeshme kohët e fundit në Bashkinë Memaliaj kemi menduar vendosjen e një tarife për kamerat (rulot) të cilët qëndrojnë në zonën e përcaktuar (për gjatë bregut të lumit Vjosë, në qytet Memaliaj) me 500 leke/1-5 ditë.

	- TARIFA PËR KAMPERAT BRENDË TERRITORIT TË BASHKISË MEMALIAJ	Leke/ ditë
	- Për çdo kamper (për gjatë bregut të lumit Vjosë, në qytet Memaliaj)	500 lekë /1-5 ditë

Konceptoi
V.Xhelollari
A.Isomati


